



Pranuar / Dorezuar Pimljeño/Prodato Received/Delivery	30.01.24	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlyerja Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKAMSHCK	559/2024		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr 1498/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1498/2023, të datës 07.12.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në çështjen juridike “kundërshtim i masës disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet** Vendimi ASNHA-KD004/2023, i datës 23.11.2023, i Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, ndërsa, *çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje* të organit i cili i ka nxjerrë aktin administrativ të kontestuar.
- II. Obligohet** Komisioni Disiplinor në Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rishqyrtimin e çështjes siç përcaktohen në pikën I të dispozitivit, duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, (tani e tutje referuar si ankuesi), më datë 07.12.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit ASNHA-KD 004/2023, të datës 23.11.2023, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Shërbime të

Navigacionit Ajror, për shkak të shkeljes së rëndë të dispozitave ligjore materiale dhe procedurale, cenimit të të drejtave nga marrëdhënia e punës, si dhe dëmtimit të funksionit të auditimit të brendshëm dhe pavarësisë së tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (tutje ASHNA), ndërsa, kjo e fundit, me datë 19.12.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë, se bashku me shkresat ndërlidhur me lëndën.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7364/2023 të datës 07.12.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me nr.0606 të datës 26.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror; Takimi i Komisionit Disiplinor i datës 08.11.2023; Shënime nga takimi i Komisionit Disiplinor; Vendimin me nr.45/23 të datës 30.10.2023 për themelimin dhe përbërjen e Komisionit Disiplinor; Vendimin me nr.23/22 të datës 01.04.2022 për themelimin dhe përbërjen e Komisionit Disiplinor në ASHNA; E-mailin e datës 24.10.2023-inicimi i procedurës disiplinore ndaj E-mailin e datës 30.10.2023; E-mailin e datës 18.07.2023; Raportin gjashtëmujor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për periudhën prej 01.01.2023 deri më 30.06.2023; E-mailin e datës 03.11.2023; E-mailin e datës 07.11.2023; E-mailin e datës 15.11.2023; E-mailin e datës 17.11.2023; Takimin e Komisionit Disiplinor të datës 17.11.2023; Shënime nga takimi i Komisionit Disiplinor të datës 17.11.2023; E-mailin e datës 02.08.2023; E-mailin e datës 28.02.2023; E-mailin e datës 21.02.2023; E-mailin e datës 09.02.2023; E-mailin e datës 08.02.2023; e-mailin e datës 06.02.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 14.12.2023; Përgjigje në kërkesë nga organi i punësimit e datës 19.12.2023 bashkë me shkresat e lëndës; Akt Emërimit i datës 01.01.2020; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 31.12.2019 për pozitën Auditor i Brendshëm ; E-mailin e datës 24.10.2023 për iniciimin e procedurës disiplinore; Vendimi me numër protokolli 0637 të datës 12.12.2023 i Komisionit për Ankesa i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror; Ankesën me numër protokolli 0617 të datës 04.12.2023 të parashtruar në Komisionin për ankesa nga ankuesi; Takimin e Komisionit Disiplinor të datës 19.09.2023; E-mailin e datës 18.07.2023; E-mailin zyrtar i datës 12.07.2023; E-mailin e datës 02.08.2023; E-mailin e datës 09.08.2023 dhe E-mailin e datës 06.11.2023; E-mailin e datës 03.11.2023; Provat shtesë të dërguara përmes e-mailit të datës 19.12.2023; Vendimin e datës 12.01.2024 nga Kryetari i Këshillit për shtyrje të afatit për vendosje; E-mailin e datës 22.01.2024 nga përfaqësuesi i Njësisë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka vlerësuar që lënda e ankuesit të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi që ka nxjerrë aktin e kontestuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe së i njëjti sipas Akti të emërimit me Nr.prot: 0020 të datës 13.01.2020, ushtron pozitën e punës Auditor i Brendshëm në Njësinë e Auditimit të Brendshëm.

Tutje nga provat materiale të kësaj çështja rezulton së me datë 24.10.2023, në pozitën e zëvendësuesit të menaxherit të DATS, ka iniciuar kërkesë për procedurë disiplinore ndaj ankuesit e parashtruar pranë Komisionit Disiplinor të ASHNAS-së, mbi bazën së në cilësinë e ish anëtarit të Komisionit Disiplinor, gjatë shqyrtimit të lëndës disiplinore të zyrtares [shprehur] është vërejtura së ankuesi ka dërguar raportin 6 mujor të Auditimit përkundër vënies në dijeni se Raporti më përmbajtjen që kishte nuk autorizohet dhe nënshkruhet nga ana e drejtorit.

Komisioni Disiplinor ASHN-së Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror me Vendimin ASNHA-KD004/2023 të datës 23.11.2023, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 56 paragrafët 4.4 dhe 4.20 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publike, duke i shqiptuar masën disiplinore “*ndalimi 30% e pagës bazë për periudhën prej tre (3) muaj*”.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon që iniciimi i procedurës disiplinore është bërë nga zyrtari i cili nuk ka pasur kompetencë të inicioj procedurë disiplinore, dhe së komisioni disiplinor përkundër faktit që ka qenë në dije për ndryshimet ligjore i njëjti nuk e ka hedh poshtë kërkesën për iniciim të procedurës disiplinore dhe së me këtë veprim ka dëmtuar dhe cenuar funksionin e auditimit të brendshëm dhe pavarësinë e tij. Tutje shton së drejtoresha e auditimit me datë 12.07.2023 ka përcjell për nënshkrim raportin 6 mujor të auditimit të drejtori i ASHNA-së dhe njëkohësisht ka njoftuar të njëjtin se raporti 6 duhet të përcillet deri me datë 15.07.2023 tek Njesisë Qendrore Harmonizuese. Me datë 14.07.2023 nga Drejtoresha e Auditimit jam caktuar që të zëvendësoj të njëjtën për kohën sa do jetë në pushim, ndërsa më datë 17.07.2023 drejtori i ASHNA-së, me ka kontaktuar me telefon dhe me ka thënë” *raporti 6 mujor nuk nënshkruhet si i tillë, sepse nuk pajtohem me komentin e dhënë për arsyet e mos kryerjes së aktiviteteve të auditimit sistemi i trajnimit dhe zhvillimit, se nuk e kam penguar këtë aktivitetet por vetëm kam kërkuar ndryshimin e planit të auditimit*” mirëpo, drejtori më shkrim nuk më ka dërguar asgjë se a duhet apo jo ta përcjell raportin në fjalë tek NJQH, andaj, duke qenë në këtë situatë pas konsultimit me Drejtoreshën e Auditimit si dhe zyrtarin me inicialet V.H nga NJQH udhëzohem që të përcjell Raportin pasi që është obligim ligjor. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj vendimin ASNHA-KD004/2023 të datës 23.11.2023 të Komisionit Disiplinor të ASHNA-së.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës lëndore për vendosje lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit iu referuar dispozitave të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publike, i aplikueshëm nga data 25.09.2023, me theks të veçantë:

- Nenit 2- *Ky ligj zbatohet për zyrtaren/in publik në institucionin publik të Republikës së Kosovës. 2. Përfundimisht, marrëdhënia e punës së zyrtares/it publik rregullohet ndryshe, vetëm kur parashihet shprehimisht me këtë ligj. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë.*
- Nenit 3 - *Ky ligj nuk zbatohet për funksionaret/ët publik si në vijim: 1.1. të zgjedhurat/it; 1.2. anëtarët/ët e Qeverisë dhe zëvendëset/it e tyre; 1.3. funksionaret/ët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidentja/i i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullaret/ët apo anëtarët/ët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura, përjashtimisht pozitave të përcaktuara si në paragrafin 2. të nenit 5 të këtij ligji; 1.4. të emëruar/it politik në nivelin qendror dhe lokal, përjashtimisht*

pozitat e përcaktuara në paragrafin 6. të nenit 5 të këtij ligji. 2. Ky ligj gjithashtu nuk zbatohet edhe për kategoritë në vijim: 2.1. gjyqtaret/ët dhe prokuroret/ët; 2.2. personelin komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo të organizatës tjetër pasardhëse; 2.3. të punësuarat/it në Agjencinë Kosovare për Inteligjencë; 2.4. të punësuarat/it në Policinë e Kosovës; 2.5. të punësuarat/it në Inspektoratin Policor të Kosovës; 2.6. të punësuarat/it në Doganën e Kosovës; 2.7. të punësuarat/it në Njësinë për Inteligjencë Financiare; 2.8. drejtorin/in apo anëtarët/ët e organit drejtues kolegjal të agjencive rregullatore.

- **Nenit 5-** 1. Kategoritë e zyrtares/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit. 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunëse/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunëse/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë....

-**Nenit 6-** Nëpunësja/i civil me status të veçantë 1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës; 1.2. anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; 1.3. zyrtarët/ët e Agjencisë së Aviacionit Civil dhe Agjencisë të Shërbimeve të Navigimit Ajror, që kryejnë shërbime operative në fushën e kontrollit dhe navigimit ajror; 1.4. anëtarët/ët e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike; 1.5. të punësuarat/it në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Agjenci të saj; 1.6. të punësuarat/it në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencitë e saj, përjashtimisht Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin Policor të Kosovës; 1.7. të punësuarat/it në Administratën Tatimore të Kosovës; 1.8. të punësuarat/it në Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin.

Bazuar në kuadrin ligjor si me sipër, Kolegji konstaton së zyrtarët e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror kanë statusin e nëpunësit civil, dhe rrjedhimisht zyrtarët që kryejnë shërbime operative në fushën e kontrollit dhe navigimit ajror janë nëpunës civil me status të veçantë, dhe së të njëjtit i nënshtrohen rregullimit ligjor siç përcaktohet me nenin 6 paragrafi 2, të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, e mbi këtë bazë, rezulton së Këshilli ka kompetencë për të trajtuar çështjen administrative e parashtruar në Këshilli sipas ankesës së ankuesit me numër A.nr. 1498/2023.

Lidhur me pretendimin ankimor përkitazi me kompetencën e organit për inicim të procedurës disiplinore, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i kërkesës së datës 24.10.2023, ka konstatuar së kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit është parashtruar nga zëvendësuesi i menaxherit të DATS-it, në cilësi të ish anëtarit të Komisionit Disiplinor (i themeluar sipas Vendimit nr.23/02 të datës 01.02.2022) dhe atë mbi bazën e nenit 48 paragrafi 4.3 të Ligjit Nr.06-114 për Zyrtarët Publik. Ndërlidhur me këtë gjendje juridike, Kolegji i Këshillit ve në theks faktin e pa kontestueshëm se Ligji Nr. 06-114 për Zyrtarët Publik, ka qenë i aplikueshëm gjegjësisht në fuqi deri me datë 24.09.2023, kështu që, inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit mbi bazën e këtij ligji, nuk ka mbështetje ligjore. Rrejdhimisht me nenin 99 paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik është përcaktuar se :7. *Hyrja në fuqi e këtij ligji përbën shkas për përfundimin e mandatit të komisioneve të themeluara në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik. Në rast se këto komisione kanë në shqyrtim procedura të rekrutimit, të disiplinës apo të ankesave, duhet të përfundojnë këto procedura, dhe më pas konsiderohet se përfundon mandati i tyre*” kështu që me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, iniciuesi me përjashtim të rasteve siç përcaktohen me nenin 99 paragrafi 6 të këtij ligji, nuk ka asnjë kompetencë dhe autorizim ligjor që si ish anëtar i Komisionit Disiplinor, të inicioj procedurë disiplinore ndaj ndonjë zyrtari publik.

Për me tepër, në kontekst të çështjes si me lartë, Kolegji mori parasysh edhe dispozita e nenit 103 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik me të cilin është përcaktuar së “ *Me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij, përshtatshmërisht vlejné aktet nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, rrejdhimisht, duke qene së në kohën e zhvillimit të procedurës disiplinore të ankuesit, nuk ka pasur një akt nënligjor të nxjerrë nga organi kompetent lidhur me procedurën disiplinore siç përcaktohet me nenin 59 paragrafi 9 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Kolegji ka analizuar dispozita e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, gjegjësisht nenin 6 ku përcaktohet se: *Paraqitja e shkeljeve disiplinore 1. Nëpunësit civil të institucionit, kur kanë dijeni apo dyshojné për shkelje disiplinore, të kryera nga nëpunës të tjerë të të njëjtit institucion, duhet të raportojné atë me shkrim Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të nëpunësit civil për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen. 2. Kur shkeljet janë paraqitur nga qytetarët apo institucione jashtë strukturave të institucionit ku bën pjesë nëpunësi civil për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen, ato i raportohen zyrtarisht institucionit përkatës..* “ si dhe nenin 7 ku parashihet se: *Fillimi i procedurës disiplinore 1. Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, nëpërmjet ankesave nga qytetarët apo institucione jashtë strukturave të institucionit, e vlerëson paraprakisht atë. 2. Procedura disiplinore fillon pa vonesë, me marrjen në dijeni për një shkelje disiplinore brenda afateve të përcaktuara në nenin 48 paragrafin 7 të Ligjit. 3. Nëse njoftimi i marrë nuk rezulton të ketë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vendos të mos e fillojë procedurën disiplinore, duke e arsyetuar me shkrim mos fillimin e procedurës dhe për këtë e njofton paraqitësin e shkeljes së pretenduar përmes njoftimit formal sikurse që përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 4. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit. 5. Në rast se shkelja klasifikohet sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafët 4.1 deri 4.4 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë fillon procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit. 6. Në rast kur shkelja kualifikohet sipas nenit 46 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë kërkon nga komisioni disiplinor të fillojë procedurën disiplinore sipas neni**

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1498/2023

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm së Agjencisë të Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore së Agjencisë të Shërbimeve të Navigacionit Ajror si dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.